

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS - VNM-së



Titulli i projektit: Fabrika për prodhimin e pijeve freskuese, e ujit mineral dhe ujit tjetër në shishe „Uji Sharri“

Për kompaninë: “ESSE” SH.P.K

Nr. Parcelës: P-70917002-00540-0

Vendi ashtuquajtur: Katun-Bazhderana

Zona kadastrale: Bajnicë

Komuna: Kaçanik

Dhjetor 2024

Kompania: "ESSE" Sh.P.K. me pronar Daut Esa nga Prizreni

Bazuar në rregulloren e saj lëshon këtë:

A U T O R I Z I M

Autorizohet **personi fizik Dr.sc. Edona Kabashi Kastrati e Licencuar pranë Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor për Hartimin e Raporteve të Vlersimit të Ndikimit në Mjedis, për hartimin e Raportit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis për Fabrikën për prodhimin e pijeve freskuese, e ujit mineral dhe ujit tjetër në shishe „Uji Sharri“ për Kompaninë “ESSA” Sh.P.K.**

Investitori: Kompania: "ESSA" Sh.P.K.

z. Daut Esa, drejtor _____ v.v

Hartuesi i Raportit:

Dr.sc. Edona Kabashi-Kastrati,

Nr. i licencës: 71/17

edonak88@gmail.com

+383 49 655 661

Dhjetor 2024

1.0. HYRJE

Në kuadër të zgjerimit të investimeve kompania "ESSE" SH.P.K ka paraparë edhe funksionalizimin e fabrikës për prodhimin e pijeve freskuese, e ujit mineral dhe ujit tjetër në shishe, si dhe hartimin e raportit mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis për fabrikën e cila si aktivitet kryesor ka për prodhimin e pijeve freskuese, e ujit mineral dhe ujit tjetër në shishe, në ngastrën nr. P-70917002-00540-0 në komunën e Kaçanikut, zona kadastrale Bajnicë përkatësisht në vendin e quajtur KATUN-BAZHDERANA. Pronësia e truallit ku është i ndërtuar objekti është pronë private e Afrim Tafës nga Torina e Lipjanit, ndërsa kompania "EuroFood" Sh.P.K. e ka të blerë sipas kontratës LRP.nr. 6659/2021; Ref.nr. 1906/2021, ndërsa kompania "ESSE" shpk me seli në Prizren me pronar Daut Esa e ka marrë me qera pronën dhe fabrikën nga kompania "EuroFood" Shpk.

Ky raport do të përfshijë në vete analizat e realizuara të ndikimeve të mundshme në mjedisin rrethues, duke përfshirë edhe botën e gjallë të lokacionit ku do të realizohet projekti i lartëcekur.

Uji deklorohet i pijshëm dhe mund t'u shpërndahet konsumatorëve vetëm kur plotëson parametrat e cilësisë të mirëpërcaktuara. Ai për më tepër është një nga produktet ushqimore më të kontrolluara rreptësisht. Ai i nënshtrohet kontrollës ekstreme në çdo fazë të rrugëtimit të tij, nga grumbullimi e deri në shpërndarje.

Prandaj, prodhimi i ujit të pijshëm dhe pijeve tjera freskuese kërkon ekspertizë në teknologji dhe procese të shumta, si dhe aftësi për të parashikuar kërkesat, që përfshin njohuri të sakta të burimeve ujore. Rezervat e disponueshme të ujit natyror përfshijnë ujërat nëntokësore, ujin sipërfaqësor të qëndrueshëm ose të rrjedhshëm (liqenet, lumenjtë, etj.). Zbatimi i një sistemi trajtimi për të prodhuar ujë të përshtatshëm për pije varet nga sasia e ujit në dispozicion, cilësia e tij (duke marrë parasysh variacionet e mundshme), kostot ekonomike dhe kufizimet mjedisore. Ndërsa hartimi i këtij raporti të vlerësimit të ndikimit në mjedis paraqet një dokument të nevojshëm dhe të domosdoshëm për paisjen e kompanisë me Pëlqim Mjedisor nga ana e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Qëllimi i hartimit të raportit

është evidentimi i të gjitha kushteve përreth në lokacionin ku bëhen planifikimi për investime dhe realizime të aktiviteteve përkatëse, bazuar në faktin se në kohën moderne po bëhen intervenime të vazhdueshmë në mjedisin natyror, duke ndikuar kështu në humbjen e balancës ekologjike natyrore. Bazuar në qëllimin paraprak dhe në metodologjinë e hartimit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, ky raport bëhet me qëllim të përkufizimit të ndikimeve potenciale dhe caktimin e masave të cilat do të jenë të nevojshme për t'u marrë për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet eventuale negative të këtij aktiviteti. Andaj është e nevojshme që shoqëria të ndërgjegjësohet për t'a mbajtur sa më pastër mjedisin ku jetojmë duke marrë masat e duhura për trajtimin e mbetjeve si dhe emetimin e gazeve të dëmshëm në atmosferë që gjenerohen nga zhvillimi i aktiviteteve të ndryshme. Projekti në fjalë është një projekt mjaft i rëndësishen dhe i cili do të kontribuon një fuqizimin ekomonik dhe fuqizimin e prodhimeve vendore, pasi që bënë përpunimin dhe amablazhimin e ujit të pijës, pijeve freskuese dhe ujit me gaz, si një ndër produktet më të rëndësishme dhe më të konsumuara nga faktori njëri.

Raporti paraqet në mënyrë transparente ndikimin në mjedis të projektit mbi realizimin e aktivitetit për përpunim dhe amablazhimin e ujit të pijës, pijeve freskuese dhe ujit me gaz së bashku me paisjet e tjera përcjellëse për realizimin e tij në mënyrë që të mundësohet ruajtja e mjedisit.

Ky vlerësim i ndikimit në mjedis për kompaninë "ESSE" SH.P.K, me pronar Daut Esa është hartuar, duke u bazuar në projektin e ndërtimit, karakteristikat e lokacionit, gjendjen ekzistuese të mjedisit rreth lokacionit ku është duke u realizuar aktiviteti i lartëcekur dhe dokumentit teknik ekzistues.

Detyra e përgatitjes së këtij raporti të VNM-s kryesisht ka për qëllim identifikimin e burimeve të ndotjes, vlerësimin e ndikimit të tyre në mjedis si dhe propozimin e veprimeve për parandalimin apo së paku zvogëlimin e ndikimeve negative në mjedis gjër në kufijtë e lejuar.

Raporti është hartuar në bazë të informatave të siguruar nga Ueb faqja e K. së Kaçanikut dhe Shtërpcës, si dhe nga literatura ekzistuese për zonën. Në terren janë realizuar vizita në lokacionin e projektit, janë bërë matjet e nevojshme të lokacionit me GPS, është

incizuar gjendja e terrenit dhe janë bërë fotografi për lehtësimin e përgatitjes së këtij raporti.

2. BAZA LIGJORE E PËRPILIMIT TË RAPORTIT MBI VNM

Në lidhje me vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM-së) është aprovuar dhe funksionon Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181 i cili përcakton të gjitha procedurat për përgatitjen dhe paraqitjen për miratim të VNM -së.

Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181, ka për qëllim për të siguruar mundësimin e një vlerësimi të përgjithshëm me ndërthurje të ndikimeve mjedisore të projekteve apo veprimtarive që do të realizohen me qëllim që të parandalojnë dhe të zvogëlojnë apo mënjanë efektet negative në mjedis në kohën e duhur.

Analiza përfshin identifikimin e masave mbrojtëse për mjedisin me rastin e ndonjë aksidenti në mjedis gjatë funksionimit kontinuel të aktivitetit mbi përpunimin dhe amablazhimin e ujit të pijës, pijeve freskuese dhe ujit me gaz:

- Identifikimin e burimit që rrezikon mjedisin
- Vlerësimin e ndikimit në mjedis
- Propozimin e masave themelore për minimizimin apo zvogëlimin e ndikimeve negative gjerë në kufijtë e lejuar.

2.1 Rregullativa ligjore

a) Dokumentacioni normativ

Me rastin e hartimit të raportit të VNM - së për biznesin “ESSE” shpk i cili si aktivitet do të ketë përpunimin dhe amablazhimin e ujit të pijës, pijeve freskuese dhe ujit me gaz janë marrë për bazë ligjet me të rëndësishme të aplikuara ku janë paraqitur më poshtë:

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025
- Ligji për VNM Nr. 08/L-181
- Ligji për planifikim hapësinor Nr. 04/L-174
- Ligji për ndërtim Nr. 04/L-110
- Ligji për mbrojtjen e natyrës Nr. 03/L-233
- Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147

- Ligji Nr. 03/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugë Nr. 2003/11
- Ligji Nr.08/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nrr. 04/L-197 për Kimikate
- Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja Nr. 08/L- 025
- Ligji Nr. 08/L-071 për ndryshimin e Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturinat
- Ligji për mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L-102
- Ligji për mbrojtjen nga zjarri Nr. 04/L-012
- Udhëzimi Administrativ Nr. 30/2014 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin uJOR.

b) Dokumentacioni teknik

- Projekti ideor i ndërtimit
- Çertifikata e regjistrimit të biznesit
- Çertifikatat mbi të drejtat e pronës
- Kopja e planit të ngastrave
- Plani i situacionit
- Kontrata për qiranë e palujtshmërisë/tokës
- Pelqimin komunal për lejimin e përdorimit të fabrikes

Duke marrë parasysh faktin se një pjesë e madhe e specifikave mjedisore nuk janë përfshirë në kuadër të rregullativës së sipërshënuar për nevojat e hartimit të këtij raporti është shfrytëzuar dhe rregullativa relevante ndërkombëtare si dhe direktivat përkatëse si që është direktiva e VNM-së.

2.2. Metodologjia e punës

Metodologjia e punës me të cilat bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis për biznesin ESSE shpik i cili si aktivitet do të ketë përpunimin dhe amablazhimin e ujit të pijës, pijeve freskuese dhe ujit me gaz me objektet përcjellëse, bëhet në disa faza.

a) Informatat themelore që nënkupton identifikimet si që janë:

- Burimet themelore të ndikimeve në mjedis.
- Popullata ekzistuese me karakteristikat demografike.
- Karakteristikat e dheut, topografia dhe peizazhi në lokacionin ku është planifikuar të realizohet projekti
- Klima e lokacionit me të dhënat meteorologjike,
- Sasia dhe kualiteti i ujit dhe ajërit në lokacionin më të gjerë,
- Bota bimore dhe shtazore në terrenin e analizuar.

b) Vlerësimi i ndikimeve sipas këtyre kualifikimeve

- Madhësia dhe lloji i ndotjes
- Karakteristikat dhe dominimi i materialit ndotës
- Gjendja e mjedisit në terrenin e analizuar
- Vlerësimi i shpërndarjes në hapësirë i materies ndotëse.

c) Analiza e rrezikimit të

- Njeriut
- Vlerave materiale
- Vlerave natyrore

d) Përcaktimi i masave mbrojtëse sipas rezultateve të arritura mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis në lokacionin ku është ndërtuar fabrika **për prodhimin e pijeve freskuese, e ujit mineral dhe ujit tjetër në shishe** në komunën e Kaçanikut.

Pjesa më e rëndësishme e analizës së këtij raporti i kushtohet kuantifikimit dhe vlerësimit të gjendjes ekzistuese. Hulumtimi karakterizohet me faktin se kemi të bëjmë me vendin që nuk ka të bëjë me ndonjë potencial të shprehur ekologjik. Rezultati i këtyre analizave paraqet një dëshmi mbi gjendjen aktuale të mjedisit në këtë lokacion.

3.0. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT DHE MJEDISIT

Për hartimin e një raporti të vlerësimit të ndikimit në mjedis bazë kryesore e tij janë karakteristikat themelore. Hulumtimi dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese është bërë duke i shfrytëzuar hulumtimet studimore të bëra në këtë teren.

Për t'u definuar gjendja ekzistuese në mënyrë të kënaqshme dhe për t'u krijuar një bazë reale për hulumtim të ndikimeve të mundshme, në kuadër të gjendjes ekzistuese janë prezantuar edhe të dhënat relevante që kanë të bëjnë me të dhënat ekzistuese morfologjike, gjeologjike, hidrologjike, hidrografike dhe meteorologjike.

3.1. *Potencialet ekzistuese*

Njëri nga elementet kyç të hulumtimit të gjendjes ekzistuese të mjedisit është hulumtimi i potencialit ekzistues, e që konsiston në analizën e mirëfilltë të tërësisë hapësinore në zonën më të gjerë të lokacionit ku është planifikuar të operoj fabrika **për prodhimin e pijeve freskuese, e ujit mineral dhe ujit tjetër në shishe**, me qëllim që në bazë të pasojave të njohura të vlerësohen mundësit e rrezikut ekologjik dhe në bazë të tyre të rekomandohen masat për zvogëlimin ose edhe eliminimin e tyre. Karakteristikat e potencialit ekologjik përbëhen nga kombinimi i ndikimeve të ndërsjella të faktorëve natyror siq janë toka, uji, ajri, relievi, flora dhe fauna. Secila nga potencialet ekologjike në këtë mënyrë posedon funksione të caktuara, që në esencë kanë rëndësi të dorës së parë analizën e problematikës së tërësishme të mbrojtjes së mjedisit. Ndikimi i ndërsjellë i faktorëve të veçantë si dhe ndikimi i tyre në formimin e potencialit ekologjik dhe i funksioneve të tyre themelore me interes për analizën në fjalë, së bashku me kompleksin e marrëdhënieve të mundshme është paraqitur në figurën 1.

Në bazë të raporteve të paraqitura në këtë figurë është e qartë që faktorët natyror formojnë disa potenciale natyrore karakteristikat funksionale të cilat duhen marrë parasysh gjatë valorizimit të ndikimit në mjedis të fabrikës për prodhimin e pijeve freskuese, e ujit mineral dhe ujit tjetër në shishe, që është planifikuar për të operuar në hapësirën e lartcekur.




Fig. 1. Raportet themelore ndërmjet faktorëve natyrorë dhe potencialeve ekologjike.

3.2. Të dhëna teknike te aktivitetit

Investitori për realizimin e aktivitetit të tij do të pajiset me të gjitha miratimet përkatës të lejeve të nevojshme për lejimin e operimit të fabrikës për përpunimin dhe prodhimin e pijeve freskuese, e ujit mineral dhe ujit tjetër në shishe. Pronësia e truallit ku është i ndërtuar objekti është pronë private e Afrim Tafës nga Torina e Lipjanit, ndërsa kompania “EuroFood” Sh.P.K. e ka blerë sipas kontratës LRP.nr. 6659/2021; Ref.nr. 1906/2021, ndërsa kompania “ESSE” shpk me seli në Prizren dhe pronar Daut Esa e ka marrë me qera pronen dhe fabrikën nga kompania “EuroFood” Shpk. Objekti ka këto të dhëna urbanistike:

- Sipërfaqe e pronës 5141.00 m²
- Sipërfaqe ndërtimi 1323.29 m²

3.3. Pozita gjeografike e lokacionit

Hartimi i Raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis ngërthen në vete karakteristikat themelore të gjendjes egzistuese, të gjendjes së lokacionit së bashku me kushtet klimatike e demografinë të vendit. Hulumtimi dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese është bërë duke i shfrytëzuar hulumtimet studimore të bëra në këtë teren, përmes analizave vizuele dhe informatave të marra nga ana e vetë personave përgjegjës të kompanisë “ESSE” SH.P.K.

Fabrika gjendet pranë rrugës Gërlicë e Eperme-Shterpçës në vendin e quajtur Bungu-Bazhdarana, më saktësisht fabrika është ndërtuar në ngastrën kadastrale nr. P-70917002-00540-0 sipërfaqe rreth 5141 m², zona kadastrave Bajnicë komuna e Kaçanikut, Lokacioni gjendet në gjerësi dhe gjatësi gjeografike me 75° 12'33" N dhe ne 46° 82'21" E, dhe lartësi mbi detare 700 m.

Territori i fabrikës uji sharri veçohet me një relief kodrinor i kushtëzuar nga përbërja gjeologjike komplekse me ndërtim gjeomormologjik të theksuar me ndryshime të larta të terrenit. Terreni shtrihet në pjesën lindore të Shterpçës në kompleksin industrial të fabrikës për prodhimin e pijeve freskuese, e ujit mineral dhe ujit tjetër në shishe “Uji Sharri” afër fshatit Gërlicë e Eperme i cili karakterizohet me relief të thyerë kodrinor me lartësi mbidetare mbi 700m. Lokacionin i ngushtë ku është ndërtuar fabrika është terren kryesisht i rrafshhtë i tipit livadh, me bimë të ulëta barishtore. Ndërsa terreni i gjerë i kësaj zone është i mbuluar me vegjetacion të lartë dhe karakteristike e kasaj është se zona i takon pjesë së pellgut të Lumit Lepenci ose vargmaleve të Sharrit.

Figura 2, tregon vendndodhjen e fabrikës së ujit brënda teritorit të Kosovës dhe hartën topografike të këtij territory, si dhe vëndodhjen e puseve bashkë me kordinatat në përgjithësi.

RAPORTI I VNM-së




Figura 2. Pamje satelitore dhe harta topografike e terrenit të fabrikës "ESSE" shpk, "Uji i sharrit"

RAPORTI I VNM-së

Komuna e Kaçanikut ndodhet në juglindje të Kosovës. Në jug komuna kufizohet me komunën Han i Elezit, në lindje me Shtërpçën, në veri me Ferizajn dhe në perëndim me Vitinë. Zona e komunës ka një sipërfaqe prej 221 km². Së bashku me komunat Han i Elezit, Ferizaj, Shtime dhe Shtërpçë, formon Rajonin e Ferizajit. Komuna e Kaçanikut ka 31 vendbanime, dhe nga regjistrimi i vitit 2011 tregoi se komuna e Kaçanikut kishte një popullsi prej 33,409.

Në territorin e analizuar, dhe më gjerë, klima ka të bëjë me ndikimet e brezeve klimatike Evropiane subtropikale të matura, mes rajoneve mesdhetare kontinentale edhe atyre kontinentale-europiane. Klima mesdhetare kontinentale është e njohur sipas sasive më të mëdha të reshjeve në periudhat dimërore, kurse verës ky rajon është nën ndikimin e ciklonit azotik me masa ajrore me prejardhje tropikale, që ka si pasojë vera të nxehta dhe të thata. Në rajonin kontinental evropian janë të theksuara – dominojnë reshjet e mëdha në muajt e pranverës dhe verës në raport me ata të dimrit, sipas të dhënave të IHMK.





Figura 3. Foto pamje nga lokacioni ku ndodhet Fabrika

3.4. Popullsia dhe vendbanimet

Kur është në pyetje hartimi i VNM-së, ndër veçoritë kryesore janë edhe popullata, zhvillimet demografike si dhe vendbanimet. Kjo vjen në shprehje për shkak se afërsia e vendbanimeve dhe popullatës ndaj aktiviteteve janë, ndër faktorët kryesor të cilët i ekspozohen ndikimeve në mjedis. Fabrika ku është ndërtuar është zone malore dhe një

vendë shume i përshtatshëm për realizimin e kësaj veprimtarije. E gjithë kjo ka ndikim në strukturën ekonomike të Kaçanikut dhe Shtërpcës me rrethinë. Fabrika e lartpërmendur në pikëpamje mjedisore nuk pritet të ketë ndonjë ndikim negativ në mjedis duke pas parasysh aktivitetin e përpunimit dhe për prodhimin e pijeve freskuese, e ujit mineral dhe ujit tjetër në shishe “Uji Sharr”, ndërkaq në anën tjetër pritet të ketë efekte pozitive në aspektin social-ekonomik respektivisht në punësimin e banorëve lokal dhe fuçizimin e prodhimit vendor.

3.5. Lidhjet e Komunikacionit

Fabrika për prodhimin e ujit të ambalazhuar, pijeve freskuese dhe ujit me gazë “Uji i Sharrit” sa i përket së infrastrukturës rrugore ka lidhje të mira të komunikimit rrugor me qendrat tjera në Kosovës dhe rajonit për plasmanin e prodhimit në tregun e jashtëm. Pranë fabrikës për prodhimin e pijeve freskuese, e ujit mineral dhe ujit tjetër në shishe “Uji i Sharrit” kalon rruga regjionale Ferizaj – Gërlicë - Shtërpcë që lidhet me autostradën Prishtinë - Shkupë. Kjo lidhje e mirë e komunikacionit rrugor ka mundësuar kopanisë të ketë vlerën ekonomike e sidomos pas periudhës së shitblerejs së kompanisë kur kompania kishte fillimin e ngritjes si ndërmarrje e trashëguar nga kompania “Uji i Sharrit” si një prodhuesit të njohur jo vetë për tregun vendor por edhe atë ndërkombëtar.

3.6. Kushtet klimatike

Duke ju referuar te dhënave meteorologjike nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës, në territorin e Komunës së Kaçanikut dhe Shtërpcës mbizotëron klimë kontinentale me ndikim mesdhetar. Klima përbën një grup të proceseve atmosferike të cilat përshkruajnë gjendjen fizike të atmosferës mbi ndonjë territor. Studimi i faktorëve klimatik dhe elementeve klimatike në cilindo territor ose regjion është shumë i rëndësishëm për shumë degë të ekonomisë. Qëllimi kryesorë i studimit është që të ofrohen sa më shumë të dhëna për klimën dhe specifikat e saj të cilat do të jenë të rëndësishme për të gjithë shfrytëzuesit real dhe potencial. Mirëpo, sa do të arrihet sukses varet nga cilësia dhe sasia e të dhënave të mbledhura nga terrenin, respektivisht nga niveli i organizimit të rrjetit për

grumbullimin e të dhënave klimatike-meteorologjike. Në mungesë të informatave në afërsi të vendit të studimit për karakteristikat klimatike, të dhënat për klimën janë merr nga stacionit klimatik në Ferizaj dhe Jazhincë. Në keto stacione ka më shumë vrojtimit – matjet shumëvjeçare meteorologjike. Për shkak të kësaj, tek analiza e elementeve klimatike do të analizohen elementet fillestare të cilët janë marrë për shqyrtimin e kësaj problematikë.

Në territorin e analizuar, dhe më gjerë, klima ka të bëjë me ndikimet e brezeve klimatike Evropiane subtropikale të matura, mes rajoneve mesdhetare kontinentale edhe atyre kontinentale-europiane. Klima mesdhetare kontinentale është e njohur sipas sasive më të mëdha të reshjeve në periudhat dimërore, kurse verës ky rajon është nën ndikimin e ciklonit azotik me masa ajrore me prejardhje tropikale, që ka si pasojë vera të nxehta dhe të thata. Në rajonin kontinental evropian janë të theksuara – dominojnë reshjet e mëdha në muajt e pranverës dhe verës në raport me ata të dimrit.

Tabela 1. Parametrat kryesor klimatike, (IHMK).



3.7. Reshjet

Reshjet kanë rëndësi të veçantë në aspektin hidrologjik dhe hidrogeologjik. Në rend të parë reshjet kanë ndikim direkt në sasinë e ujërave sipërfaqësor dhe indirekt në furnizimin dhe debitin e ujërave nëntokësor. Në rend të dytë matjet sistematike të reshjeve mundëson studime më të thella hidrologjike dhe planifikimet afatgjate në sektorë të

RAPORTI I VNM-së

ndryshëm të ekonomisë. Për analizimin e regjimit të reshjeve janë shfrytëzuar të dhënat historike nga Institute Hidrometeorologjik i Kosovës nga stacionet meteorologjike dhe hidrometeorologjike të cilat pozicioni hapsinor i tyre është paraqitur në tabelën e reshjeve. Për territorin i cili është marrë për hulumtim, matjet e reshjeve janë evidentuar në tri stacione kryesore meteorologjike dhe hidrometeorologjike: Ferizaj dhe Jazhincë.

Tabela 2 Reshjet mesatare mujore per stacionin Ferizaj dhe Jazhincë

Stacioni	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjetore
Ferizaj	49	45	49	52	80	71	62	49	51	60	68	55	691
Jazhincë	87	72	81	85	114	93	81	53	75	78	97	91	1007




Figura 3. Paraqitja grafike mesatare e reshjeve nga tabela e sipërme

Nga grafiku mund të konkludojmë që stacioni në Jazhincë ka sasi më të madhe të reshjeve se stacioni në Ferizaj, dhe po ashtu zbritja e sasive të reshjeve, gjatë stinës së pranverës në verë, është me gjatë se e stacionit në Ferizaj. Ndërsa sa i përket shpërndarjes kanë pothuajse të njëjtën shpërndarje. Që të dy stacionet maksimale të reshjeve kanë në

muajin Maj, dirsa minimalen e kanë në muajin gusht. Në tabelën 3 janë të paraqitura reshjet ekstreme (maksimale dhe minimale) vjetore për Ferizaj dhe Jazhincë.

Tabela 3. Reshjet shumvjeçare ekstreme.

Stacioni	Maksimale	Viti	Minimale	Viti
Ferizaj	954	1976	466	1950
Jazhincë	112	1955	788	1948

Kjo tabelë paraqet reshjet ekstreme në periudha të ndryshme të paraqitjes së reshjeve me probabilitet 100, 10, 4 dhe 2 vjet. Për me prurje estreme të paraqitjes së reshjeve për 100 vjetë, duhet të merret gjasa e paraqitjes së shiut një ditorë (24orë). Në tabelën 4 janë dhënë reshjet ekstreme të cilat janë marrë si të dhëna hyrëse për metodën SCS.

Tabela 4 Maksimalja e reshjes

Nr	Stacioni	P=100 vjet
1	Ferizaj	95
2	Jazhincë	112

3.8. Erërat

Erërat me drejtimet e lëvizjes dhe shpejtësinë e tyre janë faktor i rëndësishëm në formimin e kushteve të jetës, por edhe në përcaktimin e ndikimeve mjedisore. Lokacioni i fabrikës, karakterizohet kryesisht me erëra frekuencën me të madhe vjetore në këtë rajonin kanë erërat verilindore (NE) me 226 0/00 ndërsa më të voglën ato lindore (E) me gjithsej 36 0/00. Shpejtësia mesatare është më e madhja të era jugperëndimore (SË) 4.0 m/sec sipas të dhënave të IHMK. Shtypja atmosferike sipas pozitës gjeografikë të Kaçanikut dhe Shtërpcës ndryshimet e elementeve dhe dukurive atmosferikë janë në konditat normale të ndryshimit të shtypjes atmosferike për këtë rajon.




Figure 5. Trendafili i erërave

3.9. Flora dhe Fauna

Ndikimi dhe operimi i fabrikës për prodhimin e pijeve freskuese, e ujit mineral dhe ujit tjetër në shishe “Uji i Sharrit”, në domenin e florës dhe faunës paraqet dukuri që kërkon shqyrtim të kujdesshëm, në kuptim të evidencimit të pasojave të ndryshme të mundshme negative dhe zvogëlimit të tyre brënda kufijve të pranueshëm. Komunitat e Kaçanikut dhe Shtërpces të shtrira në jug të Kosovës me terren kodrinor dhe malore kanë ndikua edhe në përhapjen e botës bimore dhe shtazore. Malet e Sharrit paraqesin begati të llojeve bimore me një numër të madh të llojeve. Malet e Sharrit janë shpallur park nacional dhe një pjesë i takon komunës së Kaçanikut dhe Shtërpces. Në këto male janë konstatuar 2000 lloje bimore dhe 68 bashkësi bimore. Në mesin e këtyre llojeve 86 janë deklaruar me rëndësi ndërkombëtare. Në pjesën kodrinore dominojnë pyjet me mjaft lloje dhe janë të përziera. Prej drunjve dallohen pyjet gjetherënëse si: ahu (*fagus sylvatica*), qarri (*quercus cerris*), bungu, shkoza (*carpinus orientalis*). Në rrëzat e maleve të Sharrit dallohet ahu si më i përhapur por edhe me dimensione (gjatësia dhe trashësia e drurit). Përhapje më të kufizuar kanë llojet tjera që paraqiten si të vetmuara si: brekia, bliri (*tilia kordata*), frashri etj. Përhapje kanë edhe tipet tjera që janë të ulëta lloji i shkurreve si thana (*cornus mas*), murrizi (*crataegus monogyna*), kaça (*rosa canina*), manaferra e egër (*rubus fruticosus*), shtogu (*sambucus nigra*), kulumbria (*prunus spicosa*), lajthia (*corylus avellana*), në vise të

larta fieri shqiponje (*pteridium aquilinum*) etj. Prej bimëve barishtore ka lloje të ndryshme si ato që rriten në ambient të hapur pa prezencë të drunjëve si edhe ato që rriten brenda pyjeve. Këtu rriten edhe bime që pas trajtimit përdoren si është çaji i malit (*origanum vulgare*), kantarioni (*hypercium perforatum*), kamomili (*matricaria chamomila*), dredhëza (*fragaria vesca*), etj. Në lartësitë mbi 1500 m shtrihen kullotat malore që janë bimë barishtore të ulëta dhe për shkak kushteve klimatike nuk ka pyje. Edhe pse Malet e Sharrit e kanë mjaft lloje të pyjeve gjethembajtëse, në territorin e kësaj komune ka fare pakë pyje gjethembajtëse. Hapësira e rrafshët e komunës është e vogël pa drunj të dendur zakonisht rritet shelgu (*salix alba*) në brigje të lumenjëve. Bimë të ulëta ka mjaft si është lulëkuqja që rritet zakonisht në grunaja (*papaver rhoeas*), hithi (*urtia dioica*), formacionet e livadheve si tërfilli dhe shkurre të rralla. Livadhe ka pakë në këtë komunë.

Fauna - Fauna është me mjaft lloje që nuk janë karakteristike vetëm e këtyre hapësirave. Në pyje jetojnë ujku (*canis lupus*), dhelpra, lepuri (*lepus europaeus*), iriqi (*ernaceus europeus*), etj. Në viset e larta malore është i njohur ariu i murrmë (*ursus arctos*), dhia e egër (*rupicarpa rupicarpa*), kaprolli (*capreollus chrysaetos*). Nga hapësira e Sharrit e ka prejardhjen raca autoktone e qenit Pastori Ilir që në popull njihet si Qeni i Sharrit. Jeton gjarpri i ujit (*natrix natrix*), gurit (*vipera ammodytes*), bollujca (*tropidonatus natrix*), kërmilli i vreshtës (*helix pomatia*), breshka e rëndomtë (*testudo bermanni*). Peshq nuk ka shumë lloje, në lumin Lepenc më kryesorët janë trofta e përroskave që jeton në ujëra të shpejta dhe ftohta, mustaku i përrenjve, bërcoku, mlyshi, krapuliqi, krapu etj. Insekte ka shumë lloje si janë: fluturat, milingonat që bëjnë koloni dhe janë disa lloje, merimanga, kaçadreri (*lucanus cervus*) etj. Prej shpezëve jetojnë mjaft lloje si trishtili kokëzi (*parus major*), zogu i malit, pëllumbi i egër (*Columbia livia*), qukapikthi (*dryobates major*), laraska (*pica pica*) qyqja (*cuculus canorus*) etj. Shpezë grabitqare që jetojnë janë shqiponja e zezë (*aquilachyretos*), petrity (*malco tinnunculus*). Shpezë shtegtarë që jetojnë janë dallëndyshja, lejleku etj.

3.10. Peisazhi

Peizazhi, paraqet një nga veçoritë e rëndësishme të cilat duhet trajtuar në kuadër të vlerësimit të ndikimeve në mjedis. Edhe pse si definicion, paraqet një tërësi të elementeve natyrore, me vlerë vizuale dhe relaksuese, që d.m.th. në kuptimin e ndotjes dhe emisioneve nuk paraqet efekte direkt në shëndet, megjithatë kjo duhet trajtuar dhe vlerësuar me kujdes. Rajoni i hulumtuar ka peizazhe po kodrinoro malor.

Ndërsa, siç është përshkruar më lartë, lokacioni i fabrikës së lartpërmendur veçohet me një relief kodrinor i kushtëzuar nga përbërja gjeologjike komplekse me ndërtim gjeomormologjik të theksuar me ndryshime të larta të terrenit.

Terreni shtrihet në pjesën lindore të Shterpcës në kompleksin industrial të fabrikës për prodhimin e pijeve freskuese, e ujit mineral dhe ujit tjetër në shishe “Uji i Sharrit” afër fshatit fshatit Gërlicë e Epërme i cili karakterizohet me relief të thyerë kodrinor me lartësi mbidetare mbi 700m.

Terreni është i mbuluar me vegjetacion të lartë dhe karakteristikë e kasaj është se zona i takon pjesë së pellgut të Lumit Lepenci ose vargmaleve të Sharrit.

Në bazë të Kopjes së Planit, parcela është e vlerësuar si tokë bujqësore – Arë e klasit 5 dhe d.m.th. ka produktivitet mesatar për kulturat bujqësore tradicionale të zonës. Prandaj, ky projekt nuk paraqet ndonjë kundërshtim, konflikt apo pa pranueshmi në kuptimin peizazhi.

3.11. Ajri

Rezhimi i temperaturave të ajrit për rajonin e analizuar, do të paraqitet baza e të dhënave nga stacioni klimatik në Ferizaj, për të cilat disponohet me vrojtme shumë vjeçare. E qartë është, se për rajonin dhe lokacioni i ndërtimit të fabrikës për prodhimin e pijeve freskuese, e ujit mineral dhe ujit tjetër në shishe “Uji i Sharrit”, duke pas parasysh pozitën e lartësisë, mund të priten diç rezhim i temperaturave më të ultë dhe i

temperaturave kontinentale. Në tabelën 5 dhe figurën në vijim, janë të paraqitura vlerat mesatare mujore dhe vjetore të temperaturave për stacionin në Ferizaj.

Tabela 5 vlerat mesatare mujore dhe vjetore të temperaturave

Stacioni Ferizaj	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjetore
Mesatare	-1.4	1.0	4.4	10.0	14.7	18.1	20.0	19.8	15.8	10.3	5.6	0.7	9.91
Maksimale	1.9	6.0	7.9	12.8	17.7	20.2	22.0	24.1	18.7	14.4	8.2	5.3	13.27
Minimale	-5.5	-6.0	-0.6	6.5	12.3	15.9	18.1	15.5	13.2	6.3	0.6	-2.9	6.12




Figura 4. Temperaturat mesatare, maksimale dhe minimale të ajrit për stacionin Ferizaj

3.12. Reshjet e Borës

Shfaqja e borës, kohëzgjatja e mbulesës së borës dhe lartësia e saj, janë paraqitur përmes shtjellimit të të dhënave vrojtuese në stacionet në Ferizaj. Këto nuk janë të vetmet stacione ku është bërë vrojtimi i këtyre dukurive meteorologjike, por ato janë me të dhënat më të kompletuara dhe me periudha më të gjata të vrojtimit. Pavarësisht të dhënave mbi borën të cilat janë mbledhur në to, mund të japin një pasqyrë të numrit të ditëve me borë, lartësisë dhe kohëzgjatjes së mbulesës së borës në tërë territorin e zonës së gritjes së fabrikës për prodhimin e pijeve freskuese, e ujit mineral dhe ujit tjetër në shishe “Ujit i Sharrit” dhe më gjerë. Nga të dhënat për numrin e ditëve me borë mund të konkludohet

se mesatarja vjetore e borës është 28 në Ferizaj, 38 ditë në Prishtinë. Siç shihet, kjo dukuri është mjaft e pabarabartë në këto lokalitete, por ato nuk paraqesin ndonjë varësi të fuqishme me terrenin e lartësisë mbidetare, por janë të lidhura me karakteristikat mikroklimatike vendore të regjionit. Kështu për shembull në bazë të të dhënave nga perioda 1950-1965 kur bora është vrojtuar në më shumë stacione, mund të vërehet se Prishtina, Ferizaji mesatarisht kanë numrin e njëjtë të ditëve me borë gjatë vitit (30) edhe pse gjenden në lartësi të ndryshme mbidetare, ndërsa nga ana tjetër kur vrojtohen lokaliteti për Jazhinca të cilat gjenden në lartësi mbidetare mbi 950 m.l.m, ditët me borë ndryshojnë edhe për 15 ditë (prej 30 gjerë 45). Megjithatë, pavarësisht nga konstatimet e mëparshme bazuar në të gjitha vrojtimit mund të vlerësohet se numri i ditëve me borë ndryshon me lartësi mbidetare. Mesatarisht bora fillon me ra në Nëntor (25.XI), dhe pushon së rami në fillim të Prillit(5.IV), duke potencuar, që këta kufi ndrrohen me lartësi. Muaji janar është më i frekuentuari për ditë me borë në të gjitha stacionet matëse, pastaj vie muaji shkurt.

3.13. Karakteristikat hidrologjike

Lumi më i rëndësishëm nga objekti i ndërtimit të fabrikës për prodhimin e pijeve freskuese, e ujit mineral dhe ujit tjetër në shishe “Uji i Sharrit” është Lumi i Lepencit me lartësi Pusi I=385, 61 m, Pusi 2=372.72 m. Pellgu i Lumit të Lepencit ka sipërfaqe ujëmbledhëse rreth 584 km², duke drenuar ujëratë e pellgut te lumit Lepenc, dhe lumit Nerodime. Lumi Lepenc buron në majet e bjeshkëve të Sharrit në lartësi mbi 1520 m.l.m. Prej burimit deri te profili i analizuar (bashk me lumin Nerodime). Ndryshimi i lartësive mbidetare nga burimi deri te profili janë nën 1220m. Janë analizuar gjithsejtë 2 stacione hidrometrike, është gjetur lidhja korrelative e stacioneve me të dhëna e serive ditore, pastaj për secilën seri janë mbushur të dhënat të cilat kanë mungur, duke u bazuar në lidhet korrelative që kanë ekzistuar. Këto të dhëna nuk do të jenë pjesë e këtij dokumenti, por vetëm do të jenë disa rezultatë të cilat do të në shërbejnë për plotësimin e këtij dokumenti.

Përpunimi bazë dhe kompletimi i të dhënave hidrologjike janë kryer për të dy stacionet (Stacioni Hasni i Elezit, dhe Firaja). Për kompletimin e shenimeve hidrologjike janë

RAPORTI I VNM-së

shfrytëzuar të gjitha bazat e vjetarëve hidrometeorologjikë të cilat janë marrë nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës. Për analizat do të i referohemi të dhënat nga stacioni hidrometrik në Hanin e Elezit.

Në grafiku 6, janë dhënë të gjitha prurjet ditore stacionit hidrometrik në Hanin e Elezit, ndërsa në pjesën e më poshtë të njëjta do i paraqesim në forma tabelare si seri të prurjeve mujore.




Figura 6. Paraqitja grafike e prurjeve eksteme të Lumit Lepencit.

Tabela 6 Paraqitja tabelare e prurjeve eksteme në viti 1963 ka paraqitje më të madhe të pikut të prurjeve.

Nr.	Viti	Piku (m ³ /s)
1	1963	184
2	1964	53
3	1965	76.6
4	1966	78
5	1970	72
6	1971	63.3
7	1980	89.5
8	1981	64.5
9	1982	52
10	1983	159
11	1984	56.7




Figura 7 Rrjeti Hidrografik dhe paraqitja 3D e pellgut të lumit Lepenc

Objekti i fabrikës gjendet ne afersi te lumit Lepenc me një distance prej 300-400 m, mirpo fabrika nuk ka shkrakime te ujrave te ndotur në këtë lume.

3.14. Karakterizimi Hidrogeolgjike

Përshkrimi i sistemit të akuiferit

Baseni ujëmbajtës që përbëhet nga sedimentet deluviale me argjila dhe zhavorri me ndërshtresa dhe thjerrëza të blloqeve të gëlqerorëve ofron kushte të favorshme për rrjedhjen dhe mbajtjen (grumbullimin) e ujërave nëntokësore në brezin e zones komplese te Ujit te Sharrit.

Sedimentet në vendin e hapjes së puseve posedojnë porozitet dhe koeficient të filtrimit (përçueshmëri hidraulike, përshkueshmëri) jo të lartë. Kjo pjesë për shkak të ndërtimit

hidrogeologjik. Metamofrite kan përshkueshmërisë së ujit jo të lartë të ujërave nëntokësor. Rrjedhja e ujit nëntokësor në depozitimet deluvuale lëvizin me një shpejtësi të caktuar drejt puseve të prodhimit apo rrjedhës së ujërave drënuese.

Sedimentet me prejardhje nga Dealuvionet shtrihen pran shtratin të lumit Lepencit. Sedimentet e këtij lumenjve kanë origjinën nga sedimentet fluviale dhe ndërtojnë tarracat e Lumit të Lepencit. Në përgjithësi, litologjia e tyre karakterizohet me zhavorr në pjesët e ulëta të shtretërve të lumenjve dhe më rërë drejt pjesës anësore të shtretërve të lumenjve. Niveli i ujërave nëntokësor në sedimentet deluviale ka thellësinë mesatare, 7 m deri në 12 m. Shkëmbinjt e zonës së hapjes së puseve kanë porozitet të konsiderueshëm intergranular me thyerje dhe çarje bllokore sepse në vendin e hapjes së puseve kemi të shprehur shkarje tektonike.

3.15. Hulumtimet e ujërave nëntokësor në këtë rajon

Hulumtimet e ujërave nëntokësorë në këtë rajon dhe analizimi i cilësisë së tyre në aspektin fizik, kimik dhe bakteriologjik për ta shfrytëzuar këtë ujë me qëllim të ambalazhimit janë bërë nga kompania “Uji i Sharrit” me qëllim të plotësimit të kërkesave për procesin teknologjik të prodhimit të fabrikës.

Në këtë territor në të kalurën nuk kam pasur hulumtime të detajuara për ujëra nëntokësor, për veç puseve për qëllime të amvisërisë.

Zgjidhja e furnizimit me ujë “Uji i Sharrit”

Zgjidhja e problemit të furnizimit me ujë për objektet teknologjike për fabrikën për prodhimin e pijeve freskuese, e ujit mineral dhe ujit tjetër në shishe “Uji i Sharrit”, në lokacionit e kompleksit janë hapur dy puse, të cila plotësojnë nevojat për furnizim me ujë. Krahas nevojave për ujë për procesin teknologjik sigurisht se më parë, kësaj i ka parapri shqyrtimi i lokacionit më të përshtatshëm për hapjen e puseve, për mundësinë e gjetjes së ujërave nëntokësor.

Me rastin e hapjes së puseve sipas dokumentacioni ekzistues, është bërë regjistrimi i shtresave me qëllim të përcaktimit të shtesave ujëmbajtëse dhe ujë dhënies së puseve si dhe sigurimi i sasisë së ujit për nevoja teknologjike dhe sanitare.

Hapja e puseve është bërë me metodën e rrotacionit pa përdorim të solucionit argjilor me vendosjen e filtrave dhe mureve mbrojtëse me material PVC.

Puset janë të hapur në oborrin e kompleksit të fabrikës “Uji i Sharrit” me diametër të jashtëm 250 mm, dhe të brendshëm 200 mm, me thellësi 100 m.

3.16. Ndertimi gjeologjik

Formacionet gjeologjike

Nga pikepamia gjeologjike zonat ku është hapur puset e fabrikës për ambalazhim “Uji i Sharrit” kanë një ndertim gjeologjik të përbërë nga shumë formacione. Keto formacione janë të përbëra duke filluar nga ato me të vjetrat deri tek ato me të rejtat janë:

- 1. Shkëmbinjtë vullkanogjeno-sedimentar të Palozoikut.**
- 2. Shkëmbinjtë vullkanike të Paleozoikut**
- 3. Depozitimet Permo-Triasike.**
- 4. Depozitimet e Kuarternarit.**

Shkëmbinjtë terrigjen të Palozoikut të poshtëm.

Ne zonën e studimit takohen gjersisht shkëmbinjtë terrigjen, të cilët përfaqësohen nga:

- Rreshpe filitike (fP_{Z1})
- Rreshpe silicoro – seriticike (sP_{Z1})



Nga keta shkembinjte perhapjen më të madhe e kane shkembinjte e rreshpeve filitik dhe rreshpet silicoro - seriticike.



Shkembinjte vullkanike - bazik

Shkembinjte vullkanike bazike - Vullkanitet bazike kane perhapje te kufizuar në vendin e studimit dhe formojne ndershtresa te rrymave lavore, me trashesi të vogël ndërmjet

sekuencave terigjene turbiditike te moshes Paleozoike. Këta shkëmbinj perfaqesohen nga bazaltet, bazalte olivinike deri pikritobazalte, bazalte me titanaugit, shpesh te metamorfizuar ne kushtet e facies se shisteve te gjelbra. Këta shkëmbinj janë në kontakt me serpentinite e alteruara dhe perberja kimike evidenton përbërjen alkaline dhe i tipizon keto shkëmbinj si bazalte pikritike alkaline.

Shkëmbinjtë intruzive paleozoike kane perhapje te vogël nga zonen e studimit. Nder to veçohen gabrodiabazet, lamprofiret, monconitsienitet, granosienitet dhe granodioritet.

Gabrodiabazet takohen si trupa dajkore me permasa te konsiderueshme deri 2-3km. shtrirje dhe 150-200m. trashesi, qe intrudojne turbiditet ranoro - konglomeratike.

Serpentinete - Serpentinete janë shtrirë në pjesë jugore të zonës së studimit dhe janë të lokalizuara në kontaktë me grabrot dhe diabazët. Këta shkëmbinj i takojnë moshës së jurasikut dhe kryesisht kanë përhapje në formë të thjerrzave te lokalizuara.

Depozitimet permo-triasike - Depozitimet e Permian - Triasike perhapen gjeresisht ne rajonin e studimit. Perfaqesohen kryesisht nga konglomerate - ranore te kuqerremte te facies epikontinentale, si dhe nga konglomerate-ranore te gjelber me thjerrza gelqeroresh pelagjike. Konglomerato - ranoret e kuqerremte jane ekuivalente te formacionit "Verrucano". Ranoret jane kokerr trashë tip grauëak, ndersa konglomeratet paraqiten pergjithesisht te ngopur ne zaje. Keto te fundit paraqesin shkalle te mire rrumbullakesie, me diameter 5 - 10 - 25 cm dhe perfaqesohen nga kuarcite, granite, ranore kuarcore, shiste, ignimbrite, rralle epidiabaze etj. Trashesia e konglomerateve leviz ne kufij te gjere nga metrat e para deri ne 230 m.

Depozitimet e kuaternarit - Depozitimet e formacioneve te shkrufta takohen ne gjeresisht ne zonen tone te studimit sidomos ne pjeset e poshteme të rrjedhjeve të lumenjeve. Depozitimet e formacioneve te shkrufta perfaqesohen nga:

- ✓ Depozitimet aluviale (alQh)
- ✓ Depozitimet aluviale proluviale (al - prQh)

RAPORTI I VNM-së

✓ Depozitimet deluviale (dlQh)

Depozitime aluviale - Depozitimet aluviale takohen gjerësisht në zonën e studimit dhe përfaqësohen në pjesën e sipërme të lumenjve kryesisht nga materiali i trashë blloqe e popla. Me pakësi material mbushës i tyre janë zhavorret, rerat e suargjilat, kurse në pjesën e poshtme kryesisht nga zhavorret, rerat e suargjilat.

Depozitime aluviale - proluviale - Depozitimet aluviale - proluviale të tarracave përbëhen kryesisht nga perzierje kaotike pa lidhje koelziale ose me lidhje të dobët të coprave të gurëve me rërë dhe suargjile. Këto depozitime takohen kryesisht në zonën e veprave të marrjes gjithëashtu në segmente të vegjela




Figura 8. Harta gjeologjike e zonës

4.0. PËRSHKRIMI I OBJEKTIT DHE INFRASTRUKTURA

4.1. Objektivat dhe infrastruktura

Kompania "ESSE" SHPK është themeluar në vitin 2003 me seli në Prizren në bazë të ligjeve të aplikueshme në Kosovë dhe në bazë të rregullores për regjistrimin e bizneseve afariste me numër të biznesit 810598287

Kompania "ESSE" SHPK pas procesit të privatizimit është kompani trashëguese e ish fabrikës së ushqimit Progresit Prizren dhe veprimtaria e saj kryesore e ka prodhimin e pijeve freskuese, e ujit mineral dhe ujit tjetër në shishe.

Ndërmarrja udhëhiqet nga një ekip aksionarësh dhe bordi mbikqyrës të përbërë nga aksionarët të cilët vlerën e tyre e dëshmuuan në rritjen e afarizmit në mënyrë graduale, në prodhimin e produkteve ushqimore dhe shënimin e suksese respektabile me këtë rast prodhimin e produkteve ushqimore me kualitet dhe standate Europiane. Ndërsa fabrika e ujit "Uji Sharri" e cila është e ndërtuar në Komunën e Kaçanikut, ka vetëm një objekt i cili është i ndarë sipas nevojës së shfrytëzimit dhe ka një sipërfaqe në total prej 1323.29 m², dhe është i ndarë si në vijim: 1. Hyrja e punëtoreve (ku behët edhe dezinfektimi i punëtoreve para se të hyjë në fabrikë); 2. Zyrat e stafit dhe menaxherit; 3. Dhoma e ndërrimit të rrobave; 4. Hapësira për vendosjen e Ambalazheve të ujit; 5. Hapësira për pastrimin (filtrimin) dhe trajtimin kimik; 6. Rezervuaret për trajtim; 7. Hapsira ku janë të vendosura linjat e përpunimit; 8. Hapsirat ku janë të vendosura linjat e mbushjes, peshimit dhe paketimit, etj.

Objekti i lartëcekur është nga konstruksioni i çelikut i kombinuar me konstruksion të betonit të armuar me dimensione dhe aftësi mbajtëse të parapara për mbajtjen e ngarkesave punuese. Poashtu objekti ka të instaluar dhe sistemin e ajrimit dhe ventilimit, për pastrimin e ajrit brënda objektit. Hapsirat e mureve janë të mbyllura me sandwich panele dhe me termoizolime përkatëse, kulmi është i mbuluar me sandwich panel me trashësi 10 cm.

Me poshtë do të paraqesim disa foto të organizimit të fabrikës dhe objektit të saj.



Fig. 5. Organizimi i brendshëm i Fabrikës "ESSE" Shpk

4.2. PROCESI TEKNOLOGJIK I PËRPUNIMIT DHE AMBALAZHIMIT TË UJIT TË PIJËS, PIJEVE FRESKUESE DHE UJIT ME GAZË

Nw kompaninë "ESSE" Sh.p.k., i gjithë procesi teknologjik është paraqite mëposhte në menyrë me të detajizuar. Kompania "ESSE" Sh.p.k, ka investuar në fabrikën për

prodhimin e pijeve freskuese, e ujit mineral dhe ujit tjetër në shishe, dhe ka ndërtuar një objekte mjaft të mirë, e të sigurt.

4.2.1. Informata të përgjithshme për marrjen e ujit në fabrikën e ujit “Uji i Sharrit”

Për të siguruar një proces teknologjik të rregullt është e domosdoshme të njihet përbërja kimike e ujit, kjo varet kryesisht nga lloji i ujit, toka, klima, reshjet, etj.

Zgjidhja e problemit të furnizimit me ujë për objektet teknologjike për fabrikën për prodhimin e pijeve freskuese, e ujit mineral dhe ujit tjetër në shishe “Uji i Sharrit”, në lokacionit e kompleksit janë hapur dy puse, të cila plotësojnë nevojat për furnizim me ujë. Krahas nevojave për ujë për procesin teknologjik sigurisht se më parë, kësaj i ka parapri shqyrtimi i lokacionit më të përshtatshëm për hapjen e puseve, për mundësinë e gjetjes së ujërave nëntokësor.

Me rastin e hapjes së puseve sipas dokumentacioni ekzistues, është bërë regjistrimi i shtresave me qëllim të përcaktimit të shtesave ujëmbajtëse dhe ujë dhënies së puseve si dhe sigurimi i sasisë së ujit për nevoja teknologjike dhe sanitare.

Hapja e puseve është bërë me metodën e rrotacionit pa përdorim të solucionit argjilor me vendosjen e filtrave dhe mureve mbrojtëse me material PVC.

Puset janë të hapur në objektin e kompleksit të fabrikës “Uji i Sharrit” me diametër të jashtëm 250 mm, dhe të brendshëm 200 mm, me thellësi 100 m.



Testi i pompimit - Të dhënat e fituara janë parametra të mjaftueshëm për llogaritjen e sasisë maksimale dhe optimale të prurjeve të ujit në pus me qëllim të planifikimi më të mirë të shfrytëzimit të sasisë së ujit në mënyrë racionale pa shkaktuar dëmtim të kapacitetit të ujë dhënies në pus, bazuar në kapacitetin e prurjeve të ujit në pus.

Testi i pompimit për puset e fabrikës për prodhimin e pijeve freskuese, e ujit mineral dhe ujit tjetër në shishe “Uji i Sharrit” kanë rezultuar me vlera të mira të ujë përshkuemërisë hidraulike (koeficient filtrimi) dhe ujë dhënies maksimale.

Pompimit testuese janë realizuar në kohëzgjatje sipas kushteve teknike dhe rregullave për përcaktimin e prurjeve të ujit në puse duke zbatuar me ulje të niveleve të ujit në puse.

4.2.2. Metodologjia e zbatuar e testimit të pusëve

Për përcaktimin e parametrave hidrogeologjik për sasinë e ujë dhënies së pusit, është bërë testimi eksperimental i prurjeve të pus (P-1, P-2) me një nyje monitorimi. Për

kalkulimin e koeficientit të filtrimit dhe rrezës së ndikimit, në fillim janë nxjerrë parametrat nga dokumentacioni teknik i hapjes së puseve. .

Pusët janë realizuar në lokacionin me koordinata $Y = 7512397.35$ $X = 4682229.25$ $Z = 695.20$

- ✓ $r_1 = 100$ mm Rezja e pusit
- ✓ $\varnothing = 200$ mm, diametri i pusit
- ✓ $S_0 =$ m niveli statik i ujit në pus
- ✓ $H = 92.59$ m, shtylla hidrostatike e ujit
- ✓ **$L = 100$ m, thellësia e pusit**
- ✓ $r_2 = 65.39$ largësia e pusit P_1 nga Pusi P_2

Përshkrimi Litologjik i pusit

0,0 -1,30 m Argjilë humusore

1,30 -8.7 m Argjilë me copa guralecësh produktet shpatore, zhavorri, rërë me qopëza të gelqerorëve

8.70-17.70 Argjilë me copa guralecësh produktet shpatore deluviale

17.70-35.60 Zhavor, karbonatore me argjila me popla me diametër deri 10 cm

35.60-55.00 Filite, metafilite të rreshpezuara

55.00-66.00 Filite, metafilite të rreshpezuara

66.00-85.00 Filite, metafilite të rreshpezuara

85.00-86.00 Shtresë Zhavori

89.00-100.00 Filite, metafilite të rreshpezuara

Thellsia e pusit $L = 100$ m , Diametri i pusit $\varnothing = 200$ mm;

Niveli i ujit nëntokësor në pus (nga sipërfaqja) : 7.41 m

Kapaciteti i pompimit në pus (shkarkimi)- Q (l/sec):

$Q_1 = 1.25 \text{ L/sec} = 108 \text{ m}^3/\text{ditë}$; $Q_2 = 1.62 \text{ (L/sec)} = 139.968 \text{ m}^3/\text{ditë}$; $Q_3 = 1.95 \text{ (L/sec)} = 168.48\text{m}^3/\text{ditë}$

4.2.3. Bilanci i shfrytëzimit të ujit nga kompania "esse" shpk "uji sharrit"

Në bazë të nevojave për shfrytëzimin e ujit për kompaninë "ESSE SHPK", dhe bilancin e shfrytëzimit të ujit për nevoja e të prodhimit dhe ambalazhimit ekzistojnë kapacitete të mjaftueshme të ujë dhënjes nga puset e shfrytëzimit P-1, P-2.

Për kalkulimin e bilancit të shfrytëzimit të ujit nga "ESSE SHPK", janë marrë për bazë parametrat e të procesit teknologjik të prodhimit dhe ambalazhimit të ujit dhe pijeve freskuese sipas standardit të cilat i kërkojnë stabilimentet e prodhimit.

Sasi e nevojshme e ujit për ambalazhim **83.33 L/min ose 1.38 L/sec**. Sasia mesatare e shfrytëzimit të ujit për procesin ambalazhimit të ujit (sipas të dhënave të kapaciteteve prodhuese të fabrikës) sasia e kapacitetit të ambalazhimit të ujit prej kompanisë "ESSE", do të jetë **5000 L/orë, 83.33 L/min ose 1.38 L/sec**.

4.3. PROCESI TEKNOLOGJIK I PËRPUNIMIT DHE AMBALAZHIMIT

Teknologjia ekzistuese e trajtimit të ujit të papërpunuar është përcaktuar me karakteristikat teknologjike të fabrikës sipas standarteve që duhet të ketë një fabrikë për prodhimin e pijeve freskuese, e ujit mineral dhe ujit tjetër në shishe.

– Përshtatshmëria e procedurave teknologjike lidhur me e nevojat e trajtimit të ujit sipas kapacitetit. Fazat teknologjike standarde të trajtimit të ujit janë: nëse ujërat mund të ndryshojnë cilësinë e prurjes së ujit nga shkëmbinjët rrethues pran fabrikës.

– Oksidimi kryesor i ujit të papërpunuar me klor.

– Injektimi i koagulantit dhe flokulantit në zonën e turbulencës ujit.

- Sedimentimi në sedimentuesin pulsator.
- Filtrim nëpërmjet filterave.
- Dezinfektimi i ujit të filtruar që bëhet me klor.

Përshkrimi i gjendjes së tanishme të fabrikës së ujit të pijës, pijeve freskuese dhe ujit me gazë “Uji i Sharrit”, ujë I cili është i planifikuar për pije dhe që paraprakisht është kontrolluar që uji nuk ka nevojë të ketë ndonjë trajtim të veçantë fizik apo kimik. Mirpo vetë koncepti i fabrikës së ujit duhet të ketë në disponim të gjitha proceset teknologjike për përpunimin e ujit të pijës sipas standarteve higjienike dhe shëndetsore, ISO standartet për cilësinë e ujit të ambalazuara dhe paketuara të destinuar për pije dhe prodhimin e pijeve freskuese dhe ujit të gazuar.

Filtrimi - kryhet me anë të elektrofilterave ISO standard, rregullimi i rrjedhjes së tij dhe larjes së filtrave, kryhen me një bateri prej tri valvulesh flutur për çdo fushë filtri. Bateritë e valvuleve janë të vendosura në galerinë e gypave në pjesën e poshtme të fushave të filtrave dhe mbi rezervuarin e ujit të trajtuar.

Puna automatike e pozicionerit realizohet nëpërmjet komandës elektronike të cilën e bën moduli PLC në panelin komandues, në krahasim me vlerat e lexuara të nivelit të ujit mbi filtrin me rërë. Detyra e automatikës që përbëhet nga: sonda me ultrazë, pajisja PLC, pozicioneri dhe valvula, është që të mbaj një nivel konstant të ujit mbi filtrin me rërë. Me këtë arrihet:

- Shpejtësi e njëjtë të ujit nëpër shtresën e rërës.
- Ngarkesë e njëtrajtshme në sipërfaqen e fushave të filtrave.
- Cilësi e njëtrajtshme e ujit të filtruar.
- Ngopje e barabartë e shtresës së filtrit.
- Zgjatje e kohës së punës së filtrit, që rezulton me kursim të ujit për larjen e filtrit.

Sistemi i dozimit për monitorimin e fortësisë së ujit

Sistemi për dozimin e reagensëve për trajtimin e ujit, është vendosur në galerinë e dozimit dhe përbëhet nga sistemet e mëposhtme individuale dhe autonome. Vlenë të theksohet se sistemi i dozimit duke u bazuar në analizat e ujit të parametrave fiziko-kimik në mostrat e ujit të marrura periodikisht dhe sipas metodologjisë analitike të realizuara në laboratorët të aktituara që të njëjtat janë si dokumentacione shtesë në këtë raport të Vlersimit të Ndikimit në Mjedis -VNM.

Pra sistemi i dozimit për monitorim të fortësisë së ujit dhe cilësisë së ujit në përgjithësi është si vijon:

- Sistemi i dozimit të klorit në para-klorizim.
- Sistemi i dozimit të alumin sulfatit.
- Sistemi i dozimit të polyelektrolitit.
- Sistemi i dozimit të fero klorit.
- Sistemi i dozimit të pluhurit të karbonit aktiv.

Reagjentët që mund të përdoren për trajtimin e ujit të papërpunuar që mbulojnë 99% të nevojës për trajtimin efektiv të ujit janë:

- Alumin sulfati
- Polielektroliti
- Pluhuri i karbonit aktiv

Në rast të veçanta pasi që objekti është i konstruktuar për fabrikën e ujit të pijshëm dhe ambalazhimi i tyre atëherë paisjet e tilla janë të konfiguruar edhe në rast të shfaqjes periodike të ndotësve me prejardhje të panjohur, kjo paraitje e ujit i turbulluar me mundësi të ndotëjes nga rrethanat e ndryshme atëher me metoda laboratorike do të përcaktohet lloji dhe përqendrimi i koagulantëve, flokulatëve ose absorbuesve të cilët do

të përgatiteshin dhe injektoheshin përmes të pajisjeve të instaluara për përgatitjen e reagjentëve.

4.4. PRODHIMI I UJIT TË GAZUARA DHE PIJEVE FERSKUERE

Uji i gazuar është uji i pijshëm, i cili me ftohje dhe nën presion ngopet me dioksid karboni në një përmbajtje të CO₂ deri në 0.4 - 0.5% në masën e ujit.

Ujërat minerale me origjinë natyrore të marrur nga thellësitë e tokës janë të pasuruara me kripëra acid ose alkaline, elemente radioaktive dhe mikroelemente, ato janë më të ngopura me gaz dhe kryesisht përdoren për qëllime terapeutike, por disa prej tyre aplikohen edhe si takëm. Trajtimi i ujërave minerale natyrore është filtrimi, ftohja, dezinfektimi, ngopja me dioksidin e karbonit dhe mbushja e shisheve.

Përgatitjen e ujit të gazuar. Uji i cili destinohet si ujë i pishëm ose që përdoret për të përgatitur një pije frskuse duhet të plotësoj disa kriteret të jetë: transparent, i pangjyrë, i këndshëm për shije, pa erë. Uji më i përshtatshëm është uji i butë me një fortësi e përgjithshme prej rreth 1.5 mg*eq/l. Uji që nuk i plotëson këto kërkesa i nënshtrohet pastrimit dhe zbutjes. Filtrat e rërës përdoren për të zbutur ujin, për kthjellëtesin dhe eliminimin e aromës. Pastrimi biologjik i ujit kryhet ose rrezatohet me dritë ultravjollcë, ose filtrimin e filtrave të kornizës me pllaka mikroporale nga filtrat e qeramikës. Uji me fortësi mbi 6 mg-eq/l është zbutur në filtrin e natrium-cationik. Pastrimi dhe zbutja e ujit zakonisht prodhohet në repartin e përgatitjes së ujit të bimës, nga ku është dërguar në ngopje, i.e., ngopje artificiale me dioksid karboni.

Matja e dioksidit të karbonit në ujë, tregon se me një rënie në temperaturën e ujit rritet, kështu që uji para ngopjes është ftohur në 1-2 °C. Me një rritje të presionit, tretshmëria e gazit gjithashtu rritet. Zakonisht ngopja çon në një presion prej 0.4-0.7 MPA. Prania në ujë të ajrit redukton tretshmërin e gazit, kështu që para mbushjes së ujit të zhdukur me një vakum ose duke përdorur ndryshimin në presionin e pjesshëm të ajrit dhe dioksidit të karbonit. Me një rritje në sipërfaqen e kontaktit të ujit dhe gazit dhe kohëzgjatjen e kontaktit, tretshmëria e gazit rritet. Prania e kripërave në ujë, sidomos e atyre bikarbonat,

zvogëlon treshmërin e gazit, pasi ato kimikisht e lidhin dioksidin e karbonit, kështu që uji i fortë është zbutur domosdoshmërisht.

Përmbajtja e CO₂ në ujë në prizën e Saturatorit duhet të jetë së paku 0.66% në peshë. Konsumi i gazit për prodhimin e gazrave të pijeve në të shtatorët modern është 1.01-1.2 kg për 100 litra. Humbjet e dioksidit të karbonit në procesin e ngopjes arrin 48-51%.

Pijet Freskuese - cilësia e ujit të frutave të gazuara vlerësohet kryesisht për shijen dhe aromën, ngopjen me dioksid karboni. Shija dhe aroma e pijeve duhet të shprehen qartë dhe të korrespondojnë me llojin e saj. Pije të përgatitura në lëngje me, "Qershi", "mjedër" duhet të ketë shije dhe aromë, si dhe ngjyrën që korrespondon. Për pijet me emra të kushtëzuar ("teatrale", "verë", "sode krem", etj). Shije, aroma dhe ngjyra janë vendosur nga receta në varësi të lëndëve të para të përdorura.

Përgatitja e shurupit të sheqerit. Sheqeri është përcaktuar në pije rreth 66-72%. Për sterilizim, shurupi duhet zier. Aktualisht, në vend të shurupit të zakonshëm, përdoret një shurup i kundërt, në të cilin rreth 55% e saharozës me acide organike konvertohet në sheqer invert.


Shurupin e përfunduar të sheqerit në gjendje të nxehtë filtrohet përmes filtrave. Filtrat kanë një kapacitet prej 3000 dhe 9000 l/h; Fuqia e motorit elektrik në pompë, respektivisht, 2.8 dhe 4.5 kË. Pas filtrimit, shurupi duhet ftohur deri në 25 °C në shkëmbyesit e nxehtësisë dhe të dërguar në koleksione të mbyllura, kryesisht të emaluara me kapacitet të ndryshëm, të llogaritur në nevojën dy-ditore të përbërjes në shurup. Për ngjyrosjen e pijeve në ngjyrë të verdhë dhe ngjyrë kafe vlen një produkt sferik të dekompozimit termik të sheqerit.


Gjatë prodhimit masa e shurupit është gjysëm e ngarkuar me sheqer, 1-2% e ujit shtohet dhe nxehtë me nxitje të vazhdueshme. Kur sheqeri është i shkrirë, temperatura ngrihet deri në 180 - 200 °C dhe karamelizimi i sheqerit është për aq kohë sa ajo bëhet ngjyrë kafe e errët kjo zgjat 6-8 orë dhe përfundon në një temperaturë prej 60-65 °C është vendosur në një kazan me ujë të nxehtë në një përqendrim prej 79-81%.

Pije freskuese (Uji i gazuar me fruta) - pije të marra nga hollimi i shurupeve të veçanta me ujë të gatshëm. Llojshmëria i ujërave që përdorën për prodhimin e frutave është i ndryshëm. Për një pije të çdo lloji, është i distinuar edhe përbërja e shurupit. Komponentët e detyrueshëm për të gjitha shurupet janë sheqer dhe acide dietike që i japin pijeve shije të ëmbël ose të thartë. Në varësi të llojit të pijeve, shurupi gjithashtu përfshin lëngje, ekstrakte dhe përbërje të frutave, shtesat, shtesat në frutat e agrumeve, shtesat e bimëve esenciale, verërat e rrushit, konjak apo aromën specifike të pijeve. Disa pijeve u shtohet edhe vitamina C, B1, B2, substanca tonike (alkaloide), ose edhe prodhimi pijeve energjike, ku shtohet turine dhe substanca të ngjashme që japin forcë, etj.

Fazat kryesore të prodhimit të ujërave dhe pijeve të gazuara janë përgatitja e shurupit, duke marrë një përzierje të shurupit, përgatitjen e ujit të gazuar dhe vendosjen e pijeve në shishe.

Skema e përgjithshme e procesit teknologjikë për prodhimin e ujërave të ambalazuar, ujit me gaz dhe fijeve freskuese:





Skema 1. Disa nga makineritë e përdorura për trajtim dhe ambalazhim të ujit, pijeve freskuese dhe ujit me gaz.



Fig. 6. Makineria e cila do të përdoret në procesin teknologjik për prodhimin e ujit dhe pijeve freskuese

4.2.4 Lëndet ndihmëse që shfrytëzohen për zhvillimin e aktivitetit nga kompania

Kompania për ta zhvilluar aktivitetin e vete përdorë këto lënde:

1. Uji- kompania ka hapur dy pusa për furnizim me ujë.

2. Energjia elektrike furnizohet nga rrjeti i KEDS dhe e-Kes-Co.
3. Ndërsa substancat kimike të cilat merrën në kompani të autorizuar për shitje e tyre.
4. Parashiehet të përdoren edhe shurupat e gatëshëm për proshimin e lëngjeve dhe pijeve të gazuara.

5.0. IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS

Investimi në ndërtimin dhe funksionalizimin i fabrikës së përpunimit dhe ambalazhimit të ujit të pijës, paraqet një kontribut mjaft të vlefshëm për produkte që do të ofroj si dhe për mundësitë e punësimit. Ndërsa ndikimet (presioni) në mjedis domosdo se vinë në shprehje kur vepron faktori antropogjen në mjedis, vetëm se në shkallë të caktuara duke filluar nga minimumi real i këtij ndikimi. Duke u bazuar në analizën e ndikimeve të mundshme në mjedis, paraqesim në këtë rast një analizë më të hollësishme të ndikimeve të mundshme në mjedis duke specifikuar edhe masat zbutëse që do të përdoren për të eliminuar apo për të i minimizuar këto ndikime.

Analiza e VNM-së në këtë rast realizohet duke u bazuar në projektin ideor të konceptuar e të diskutuar më lart në këtë raport si dhe nga gjendja reale në lokacionin respektivisht zonën ku është duke funksionuar fabrika. Kjo analizë kryhet me qëllim të vlerësimit të ndikimit në mjedis në dobi të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit duke mos i cenuar aspektet: kimike-fizike (ndikimet në burimet natyrore dhe degradimi fizik i mjedisit), biologjike-ekologjike (ruajtja e biodiversitetit, ndikimi mbi jetën e gjallë dhe biosferë) dhe socio-ekonomike (ndikimet e përkohshme apo të përhershme pozitive apo negative).

5.1. Ndikimet në ajër

Duke u bazuar në lokacionin ku është ndërtuar fabrika “Uji i sharrit” e cila është në periferi përkatësisht në Juglindje të qytetit të Shtërrpcës, nuk pritet të ketë ndonjë trysni në ajër për këtyre vendmanimeve në rrethinë. Ndikimet në ajër mund të vi vetëm nga lëvizja e makinerive transportuese ku një numër i gazrave lirohen, nga pluhuri i cili mund të qohet pezull dhe nga mbeturinat komunale që shkaktohen në fabrike nga ana e punëtorve.

Me gjithë këtë ne bazë te procesit që do të zhvillohet ne këtë fabrikë të nuk pritet te paraqitet ndonjë tejkalimi i vlerave te ndotjes se ajrit, por edhe nuk priten të tejkalohen vlerat kufitare të kualitetit të ajrit sipas të OBSH (ky lokalitet apo tërë ky region në aspektin e cilësisë se ajrit qëndron mire) dhe nuk priten përkeqësime lokale në cilësinë e ajrit në kuadër të lokalitetit të drejtpërdrejtë nga Fabrika. Ndikimet ne ndotjen e ajrit mund te vinë ne raste te mos kujdesit për mbetjet që lirohen, ku mundet te vije deri te hedhja ne ambient te hapur, e si pasoj e sajë mund te vije deri te ndotja e ajrit me aroma qe lirojeni këto mbetje.

5.2. Ndikimet në tokë

Aktivitetet që do të zhvillohen në këtë fabrikë nuk do të kenë ndikim të madh në tokë, përveç atyre ndikimeve qe kane qene ne hapësirën e ndërtimit te objektit. Ndërsa jashtë parcelave te kompanisë ndikimet ne toke nuk do te ketë, pasi qe nuk ka ndonjë aktivitet qe paraqet trysni anësore. Ujrat nga shkarkimi i ujerave pas procesit te trajtimit dhe pastrimit për momentin shkarkohen në lumë, pasi kompania nuk ka të ndërtuar pusetat sendimentuese dhe te trajtimit te ujerave industrial. Prandaj duke marrë parasysh natyrën e punës së fabrikës nuk parashihet të krijohen ujëra të ndotura nga procesi I punës në fabrike, përveq ujerave të zeza që krijohen nga ana e punëtorve. Ndërsa ndikime tjera si derdhje e vajrave, apo lëngjeve tjera nuk ka.

5.3. Ndikimet në ujë

Në afërsi të kësaj fabrike kalon lumi lepec, i cilat mund të ndikohet nga kjo fabrikë, Lumë i Lepenc është ne një distancë 200 km, larg nga objektet i fabrikës. Ndotja e ujerave mund te vijën nëse, ujerat nga pastrimi i pas procesit te larjës shkarkohen ne ujë rrjedha apo ujera nëntokësore. Gjatë operimeve, kualiteti i ujerave sipërfaqësore dhe nëntokësore nga aktiviteti i fabrikes mund të ndikohet në disa rrugë:

- Menaxhimi jo adekuat i ujerave të zeza – mund të rezultojë me depërtimin deri në ujërat nëntokësore.
- Menaxhimi i jo adekuat i ujerave industrial.

5.4. Ndikimet në peizazh, florë dhe faunë

Në këto zona të rajonit të Kaçanikut dhe Shtërrpces rriten llojet më të zakonshme të florës dhe faunës. Zona përreth ku është duke ushtruar aktivitetin e Fabrika, është zonë e malore, andej nuk do të ketë ndonjë ndikim të madh në florën dhe faunën. Gjithashtu, në këtë lokacion e as në zonën më gjerë deri më tani nuk është evidentuar ndonjë habitat i veçantë i llojeve të botës bimore apo shtazore. Edhe pse ky aktivitet nuk paraqet ndonjë rrezik specifik në florë dhe faunë.

5.5. Ndikimet në vendbanime dhe popullatë

Hapësira ku gjendet fabrika nuk ka ndikim negativ në popullatën e zonës, pasi që nuk ka pasur nevojë të zhvendoset ndonjë shtëpi, nuk do të bëjë ndonjë trysni gjatë operimit të sajë dhe nuk krijon shqetësim për banorët lokal. Në të kundërtën ka ndikim pozitiv në zhvillimin ekonomik të zonës dhe ndihmon në mbështetje përmes punësimit të komunitetit lokal, njëkohësisht sjell produkte të sigurta në tregun e Kosovës në përgjithësi.

5.6. Ndikimet nga zhurma

Si rezultat i natyrës së veprimtarisë së ushtruar në këtë fabrikë nuk pritet të ketë ndonjë ndikim në ngritjen e nivelit të zhurmës për mjedisin për rreth, e cila do të shqetësonte banorët e kësaj zone. Fabrika punon vetëm me një ndërrim të rregullt prej 8 orësh, prandaj kjo është edhe e favorshme për fabrikën në lidhje me zhurmën, pasi në këtë orar qytetarët janë aktiv thuaj se të gjithë dhe zhurma është edhe me pak e ndjeshme.

5.7. Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore

Aksidentet e mundshme që mund të ndodhin gjatë aktiviteteve të fabrikës vlerësohen si raste të izoluara. Nuk ka aktivitet me materie të rrezikshme të cilat paraqesin potencial të lartë për rrezikimin e shëndetit të njeriut apo mjedisit në përgjithësi. Edhe pse e gjithë puna në këtë kompani si energji e përdorë energjin elektrikë/rrymën.

6.0. MASAT E MBROJTJES SË MJEDISIT

6.1. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër

Për zvogëlimin e ndotjes së ajrit nga fabrika për prodhimin e pijeve freskuese, e ujit mineral dhe ujit tjetër në shishe, duhet që operatori në fjalë të mirëmbaje dhe ujite në mënyrë të vazhdueshme sipërfaqen e tokës ku operon në mënyrë që të mos krijohet pluhuri, duhet të i kushtohet rëndësi edhe pajisjeve makinerike që përdoren për transport që të mos të lirojnë gazra e me këtë të ndotet ajri mirëpo ato të mirëmbahen në mënyrë të rregullt, të mos lihen të ndezura pa nevojë e të lirojnë gazra. Mirëpo nga procesi i perpunimit të dhe ambalazhimit të ujit, mund të themi lirisht se ndotja e ajrit është minimale kur kthehet parasysh procesi që do të zhvillohet në të. Megjithatë gjatë operimit do të merren masat:

- Mirëmbajtje e hapësirës së fabrikës së jashtë ashtu edhe brenda saj,
- Mirëmbajtjen e rregullt të makinerisë së punës dhe makinerisë lëvizëse-motorike.
- Kompania në fjalë ka ndërmarre të gjitha masat për evitimin e ndotjes së ajrit me anë të vendosjes së sistemit të ventilimit të hapësirës së brendshme të fabrikës, dhe mbetjet e ngurta të grumbullon në kontajner të mbeturinave që pastaj i merr kompania e pastrimit.

6.2. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë dhe në tokë

Në dobi të minimizimit të ndikimeve në tokë, siç është cekur edhe më lart nga ky aktivitet nuk pritet të ketë ndikime në tokë. Pjesa më e madhe e sipërfaqes së parcelës ku operon fabrika është e zone me zhavorr dhe pjesa tjetër ku ka lëvizje motorike do të shtrohet me asfalt ose kubëza betoni. Ndotja e ujit mund të vijë nga procesi i larjes së hapësirave të brëshshme, poashtu pajisjeve që përdoren në proces teknologjik, mirëpo fabrika në fjalë këto ujëra nga procesi i larjes i nuk i grumbullon por i shkarkon direkt në mjedis. Andaj rekomandohet ndërtimi i baseneve – impiantit për trajtimin e ujërave të zeza por edhe atyre atmosferike të kompanisë në fjalë. Për minimizimin e ndikimeve do të ndërmerren masat si në vijim:

- Ujërat (kryesisht ujërat e zeza) që shkarkohen nga fabrika, të grumbullohen në grope septike, pastaj merren nga kompania regjionale të pastrimit.
- Masa e rëndësishme për zvogëlim do të jetë edhe grumbullimi dhe trajtimi i ujerave nga reshjet atmosferike si dhe mbledhjen e ujerave të shkarkuar nga të gjitha objektet të fabrikes dhe dërgimi i tyre në impiant për trajtim.
- Gjithashtu me qëllim të evitimit të ndikimeve tjera në ujëra, investitori duhet dhe do të zbatojë në përpikëri të gjitha ligjet dhe udhëzimet administrative për mbrojtjen e ujerave sipërfaqësore, ujerave nëntokësore dhe burimeve tjera të ujit.

6.3. Masat për mbrojtje nga zhurma

Fabrika për prodhimin e pijeve freskuese, e ujit mineral dhe ujit tjetër në shishe, gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij nuk shkakton zhurmë ose me mirë të themi një zhurmë të vogël e cila është brenda kufijve të lejuar. Parcela ku ushtron aktivitetin e tij, është afër rrugës regjionale që lidhe qytetin e Prizrenit - Shtërpcës me Kaçanikun dhe Ferizajin, prandaj zhurma që krijohet është thujse me e vogël se ajo e komunikacionit, si rrjedhojë e sajë zhurma nuk paraqet ndonjë shqetësim të madh. Megjithatë operatori duhet të marrë të gjitha masat e parapara sipas ligjit dhe akteve nën ligjore për parandalimin dhe zvogëlimin e zhurmës në kuadër të normave të lejuara, duhet të kontrollohen vazhdimisht pajisjet dhe impiantet të cilat prodhojnë zhurmën edhe për këtë ndikim duhet të shkurtohet në maksimum koha e mbajtjes ndezur të motorëve të mjeteve motorike, duke mirëmbajtur dhe duhet kushtuar rëndësi e veçante të gjitha pajisjeve të cilat emitojnë zhurmë gjatë procesit të punës.

6.4. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë

Parcela në lokacionin në të cilën është e vendosur fabrika për prodhimin e pijeve freskuese, e ujit mineral dhe ujit tjetër në shishe, siç është cekur edhe më lart është mjaft e përshtatshme për këtë veprimtari ngase gjenden në një zonë ku është e njohur për burime të shumta të ujit, gjithashtu cilësisht e tij, pastaj është afër rrugës dhe nuk pritet

ndikim negativ shtesë në peizazh, florë dhe faunë e lokacionit ne fjale dhe regjionit ne përgjithësi.

6.5. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë

Në afërsi të zonës së ku është e ndërtuar dhe duke ushtruar aktivitetin e saj fabrika për prodhimin e pijeve freskuese, e ujit mineral dhe ujit tjetër në shishe, është ne hapësirat e Bajnicës në komuan e Kaçanikut. Ne një distancë më të lagët ka edhe shtëpi banimi mirëpo, te njëtit nuk kanë pasur deri me tani ndonjë ankese rreth aktivitetit të fabrikës. Në distancë më të afërt nuk ka objekte tjera. Investitori ka bashkëpunim të ngushtë me komunitetin lokale të zone dhe do njofton ata me kohe për te gjitha aktivitete e mundshme që mundë të ndikojnë në vendbanim dhe në popullatën lokale gjatë këtij aktivitetit.

6.6. Masat për mbrojtje nga rreziqet dhe aksidentet mjedisore

Aksidentet e mundshme që mund te ndodhin gjatë aktiviteteve të kësaj fabrike mund të vlerësohen si raste të izoluara. Për te mos ardhur deri te ndonjë aksidenti eventual investitori i fabrikës, duhet qe te merren te gjitha masat adekuate paraprakisht. Rreziku me i madhe për ndonjë aksident vjen nga energjia elektrike si edhe pajisjet elektrike te fabrikës.

6.7. Menaxhimi i mbeturinave

Gjatë operimit të fabrikës, mbeturinat qe mbesin gjate procesit te punës duhet të mblidhen dhe te trajtohen sipas nevojës para se te hudhen ne kontinjer te mbeturinave. Mbeturinat te cilat mbesin janë mbeturinat të cilat i bënë personeli gjatë orarit te punës në fabrikë. Prandaj këto mbeturina duhet të adresohen në mënyrë adekuate, në mënyrë që ato mos të jenë faktorë ndotje në mjedis dhe të jenë në harmoni me praktikat e mira mjedisore dhe ligjet vendore në fuqi. Për largimin e këtyre mbeturinave fabrika e ujit “Uji

i Sharrit” ka marrëveshje me kompaninë për menaxhimin e mbeturinave nga komuna. Për mbetje e mundshme të këtij aktiviteti, zgjidhja është si në vijim:

- Mbeturinat ditore nga personeli do të grumbullohen dhe do të adresohen në mënyrë adekuate në kontejnerët e ndërmarrjes komunale për mbeturina,
- Mbeturinat e mbetjeve, do të merren nga kompania që është kontraktuar për këtë.
- Produktet dhe pijet e skaduara duhet fillimisht të kontrollohen nga Inspektorati dhe më pastaj të përcillen deri në asgjësim.

7.0. MONITORIMI DHE RAPORTIMI

7.1. Monitorimi

Në bazë të gjendjes faktike në terren, pasi që ky aktivitet nuk paraqet trysni mjedisore, monitorim i detyrueshëm dhe permanent i treguesve mjedisor janë të domosdoshëm. Produktet dhe ndikimet në mjedis do të kontrollohen në mënyrë të rregullt dhe për çdo rast duhen të merren masat e nevojshme komform ligjeve dhe të njoftohen organet kompetent.

7.2. Raportimi

Raportimi do të kryhet nga personi përgjegjës i autorizuar nga menaxhmenti, gjegjësisht nga ekspertet e kompanisë. Në raport, eventualisht do të përfshihen të dhënat për monitorimin e të gjitha parametrave të cilët do të jenë kërkuar në Pëlqimin Mjedisor, përkatësisht lejen mjedisore të lëshuara nga MMPHI.

8. MASAT REHABILITUESE PAS PËRFUNDIMIT TË AKTIVITETIT

Pas përfundimit të aktivitetit në fabrikë, pajimet duhet të çmontohen dhe të largohen nga ky lokalitet. Bazamentet si dhe platotë duhet të shkatërrohen, imtësohen dhe të dërgohen në depononte regjionale. Struktura përfundimtare duhet të jetë e mbuluar me dheun, e cila është adekuate me dheun e mëparshëm dhe ku do të përshtatet substratit të tokës.

Rikultivimi i këtyre sipërfaqeve të dëmtuara apo të degraduar nga ndryshimi i destinimit do të përfshij rivitalizimin në tërësi të hapësirës së dëmtuar nga veprimtaria ekzistuese. Zgjedhja e rikultivimit, dmth modelit, varet edhe nga qëllimi i përdorimit të tokës, siç do të jetë e paraparë me planet komunale.

9. KONKLUZIONE

Duke analizuar studimin e bërë për identifikimin e ndikimeve të mundshme, masave për parandalimin e ndikimeve, intervistave e opinioneve, si dhe duke iu referuar dokumenteve ekzistuese mund të konkludojmë si në vijim:

- Fabrika për prodhimin e pijeve freskuese, e ujit mineral dhe ujit tjetër në shishe, e cila është e ndërtuar, në komunën e Kaçanikut është në interes;
- Të vet investitorit për të përmirësuar kushte e punës, për të ngritur sasinë dhe kualitetin e produkteve të ujit të pijës dhe pijeve freskuese;
- Në interes të komunës sepse do të ketë një ndikim në rritjen e punësimit dhe të hyrave në komunë,
- Në interes të banorëve të tjerë lokal, sepse do të ofrohen mundësi e një ambienti me të menaxhuar, mundësi punësimi, si dhe produkte me cilësi të sigurt.

Në rast se fabrika për prodhimin e pijeve freskuese, e ujit mineral dhe ujit tjetër në shishe “Uji i Sharrit”, mirëmbahet në mënyrë profesionale dhe me standarde siç parashihet të mirëmbahet dhe me respektimin e plotë të masave të dhëna në këtë raport, si dhe me bashkëpunimin e plotë me autoritetet, kjo fabrike konsiderohet krejtësisht e pranueshëm si në aspektin mjedisor, po ashtu edhe në atë social dhe ekonomik. Duke u bazuar në natyrën e fabrikës dhe aktivitetit të saj, vendndodhjen, kapacitetin dhe intensitetin e veprimeve, mund të konstatohet se ndikimet në mjedisin lokal janë minimale, dhe tërësisht të kontrollueshme.

Mendojmë se këto të dhëna janë të mjaftueshme për raport të VNM-së dhe i propozojmë institucionit kompetent përkatësisht Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës (MMPHI-së), për dhënien e mendimit pozitiv për Pëlqim Mjedisor sipas kërkesës së investitorit-aplikuesit kompania “ESSE” Sh.p.k. me seli në Prizren.

11. Shtojcë

Bashkëngjitur këtij raporti gjeni:

- *Certifikata e regjistrimit të biznesit,*
- *Te dhënat për biznesin,*
- *Certifikata e pronës,*
- *Kopja e planit,*
- *Situacioni i terrenit,*
- *Pëlqimi i komunës,*
- *Skica e procesit teknologjik*
- *Situacioni i terrenit*
- *Kontrat a e qiramarrjës*
- *Kontrata e shitblerjes së pronës*